

Questo fascicolo è tradotto in 12 lingue

albanese, arabo, cinese, francese, hindi, inglese, russo  
serbo-croato, somalo, spagnolo, tagalog, urdu

COME...


*Percorsi di accoglienza, integrazione,  
educazione interculturale*

## PËR PRINDËRIT E HUAJ

**Si funksionon shkolla fillore në itali**

*testo in lingua albanese*

**Centro COME**  
*Cooperativa Sociale "Farsi Prossimo"*  
via Porpora, 26  
20131 Milano  
tel 02.29.53.74.62  
fax 02.20.40.11.20  
e-mail [info@centrocome.it](mailto:info@centrocome.it)



**\* RIPRODHIMI I KËSAJ BROSHURE ËSHTË  
E LEJUR DHE PËRKRAHET**



*teksti:* Scuola elementare statale  
via Brunacci, 2  
Milano

*figurat:*  
Santina Dallo

*përkthën:*

Arben Kalaja

*nën kujdesin e:*

Centro "COME..."



## NË QOFTË SE DONI TË DINI MË SHUMË?

*Mos u shqetësoni!*

Faktikisht ka qendra ku mund t'ju japin sygjerime konkrete:

Ufficio Stranieri  
Comune di Milano  
via Tadino, 12 Milano  
tel.: 02.29.40.02.29

Centro COME  
Cooperativa Farsi Prossimo  
viale Porpora, 26 Milano  
tel.: 02.29.53.74.62

*Natyrisht janë dhe prindër të tjerë të huaj që mund t'ju ndihmojnë!!!*

## UROJMË SHKOLLË TË MBARË!

## MIRËSEARDHËT në vendim tonë dhe në shkollat tona

Para së gjithash ju themi juve dhe fëmijëve tuaj “mirëseardhët” ne Itali dhe ne shkollën italiane.  
Po ju japim disa të dhëna për shkollën e detyrimit dhe në veçanti për shkollën fillore.


*Rregjistroni fëmijët tuaj menjehërë edhe se viti shkollor ka filluar dhe të keni parasysht që të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë edhe se nuk kanë dokumentat në rregull.  
(O.N.U. Marrëveshja internationale mbi të drejtat e fëmijëve)*

# 11

## NË QOFTË SE FËMIJA NUK FLET GJUHËN ITALIANE?

Për të ndihmuar fëmijën tuaj në mësimin e gjuhës së re mësuesit organizojnë aktivitete për mësimin e gjuhës italiane në të folur dhe në të shkruar.

*Në disa shkolla ka dhe mësues të specializuar që kanë për detyrë të mësojnë italishten fëmijëve tuaj.*



# 1

## SA VJET ZGJAT SHKOLLA NË ITALI ?



Shkolla e detyruar zgjat 8-te vjetë :


- 5 vjet shkolla fillore
- 3 vjet shkolla (8-te vjeçare) ndërmjetëse

Cerdhe	deri në 3 vjec
Kopshti	nga 3 në 6 vjec
Shkolla fillore	nga 6 në 11 vjec
Shkolla ndërmjetëse	nga 11 në 14 vjec
Shkolla e mesme	mbi 14 vjec

Shkolla fillore është falas. Librat jepen nga ana e shkollës, familjet duhet të blejnë fletoret, stilolapsat, ngjyrat, etj.

*Kërkoni nga mësuesit listat e materialeve.*

## 10 PËR ÇFARË SHËRBEJNË MBLEDHJET NË MES PRINDËRVE DHE MËSUESVE?



Mësuesit në periudha të caktuara takohen me prindërit për të biseduar për programin e klasës, për fëmijët, për vështirësitë dhe sukseset e tyre.

Këto takime janë shumë të rëndësishme sepse shkolla dhe familja mund të bashkëpunojnë për edukimin e fëmijëve dhe përshtatjen e tyre në ambientin shkollor.

### BISEDIMET

Çdo mësues njofton prindërit për ditën e takimit për të biseduar për fëmijët.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një takim me mësuesit.

*Në qoftë se doni të flisni për fëmijën tuaj kërkonit një takim me mësuesit.*

## 2

## ÇFARË DOKUMENTASH DUHEN PËR RREGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË SHKOLLËN FILLORE ?



**Për rregjistrimin e fëmijës në shkollë duhen :**

- çertificata e lindjes (në italisht)
- çertificata e vaksinimit (në italisht )
- dokumentat e shkollës që ka ndjekur në vendin e origjinës (në italisht)

Në mungesë të këtyre dokumentave, prindi dëshmon nën përgjegjësinë e tijë, klasën që ka ndjekur fëmija në vendin e origjinës.

**Në momentin e rregjistrimit duhet të përmbushen modularët për :**

- zgjedhja e tipit të shkollës (shiko #3)
- mësimi i fesë katolike (shiko #6)
- rregjistrimi në mensën shkollore (shiko #4)
- rregjistrimi para shkollor dhe në lojrat e darkës

*Ne qoftë se nuk keni çertifikatën e vaksinimit drejtohuni shërbimit mjeksor të shkollës dhe ju thotë se çfarë duhet të bëni*

# 9

## SI VLERËSOHEN REZULTATET NË SHKOLLË?




Çdo vit shkollor është i ndarë në dy pjesë (2 semestra): nga shtatori në janar dhe nga janari në qershor. Në janar dhe në qershor mësuesit bëjnë një vlerësim të rezultateve shkollore të fëmijës dhe përgatisin një “dokument vlerësimi” që i dorëzohet familjes.

*Në fund të klasës së pestë jepet një provim.*



### 3

## Shkolla me “kohë të plotë” ose me “orar te organizuar”?



Në shumë shkolla prindërit mund të zgjedhin njërin nga mundësitë e orarit dhe organizimit të shkollës:

- **klasa me kohë të plotë:**

40 orë në javë nga e hëna deri të premten nga ora 8.30 deri 16.30.

Është e detyruar ngrënia e drekës në shkollë.

- **klasa me orar të organizuar:**


27 o 30 orë në javë. Orari javor (1, 2, 3 ose 4 mbasdite) përcaktohet nga secila shkollë.

Nuk është e detyruar ngrënia e drekës në shkollë.

Mësimi fillon në orën 8.30.

Është e rëndësishme të jeni të përpiktë.

*Pyesni menjëherë për orarin e klasës së fëmijës tuaj.*




Në shkollën fillore fëmijët studiojnë:

- gjuha italiane
- matematika
- shkencat
- historia
- gjeografia
- studimet shoqërore
- vizatim (edukatën e paraqitjes)
- gjimnastikë (edukatën e lëvizjes)
- muzikë (edukata e muzikës)

*Në klasën e tretë fëmijët studiojnë një gjuhë të huaj*

# 4

## SI RREGJISTROHEN FËMIJËT PËR NGRËNIEN E DREKËS NË SHKOLLË?



Në disa shkolla (në Milano në të gjitha) është në shërbim mensa shkollore. Prindërit paguajnë për drekën kuota të ndryshme në bazë të ardhurave të familjes .  
Është e mundur të kërkohet një dietë e veçantë për arsye shëndetsore o për arsye fetare.


### Në sekretarinë e shkollës paraqitet:

- kërkesa e rregjistrimit në mensën e shkollës
- modeli 101 ose 740
- kërkesa për një dietë të veçantë

*Për pyetje të ndryshme ose për çdo lloj problemi drejtoheni sekretarise së shkollës.*

## MUNGESA

Çdo mungesë duhet të jetë gjithmonë e justifikuar nga prindi. Në qoftë se fëmija është sëmurë për më shumë se 6 ditë, për tu kthyer në shkollë duhet çertificata e mjekut që deklaron se fëmija është shëruar.





## SI ËSHTË NDËRTUAR KALENDARI SHKOLLOR?

Mësimi shkollor zgjat rreth 9 muaj.

Fillon në mes të muajit shtator dhe mbaron në mes të muajit qershor.

Kemi dy periudha pushimesh:

- dy javë në Krishtëlindje (zakonisht nga 23 dhjetori deri në 6 janar)
- rreth një javë në Pashkë (në mars ose në prill).

Ditët e tjera të pushimeve janë të shpërndara gjatë vitit.

*Shkolla do ju informojë çdo herë me një shënim në ditarin e fëmijës tuaj.*

*Kontrolloni gjithmonë ditarin!*



## NË QOFTË SE PRINDËRIT FILLOJNE PUNËN HERËT DHE MBAROJNË VONË?

Për tu ardhur në ndihmë këtyre problemeve në disa shkolla ka aktivitete para shkollore (në mëngjes nga ora 7.30 deri në fillimin e mësimin) dhe lojrat e mbasdites (nga 16.30 deri në 17.30).

*Kërkoni sekretarisë së shkollës të dhëna mbi kërkesën që do të paraqitni.*

## 6 MËSIMI I FESË KATOLIKE OSE ZGJEDHJA E NJE RRUGE TJETËR?

Per dy orë në javë është parashikuar mësimi i fesë katolike. Në momentin e rregjistrimit prindërit duhet të deklarojnë që zgjedhin se:

**përfitojnë ose nuk përfitojnë**

nga mësimi i fesë katolike. Në qofte se prindërit vendosin që të mos mësojnë fenë katolike fëmijëve të tyre duhet të zgjedhin njëren nga këto 3 mundësi:

- aktiviteti mësimor dhe formues
- aktiviteti i studimit ose kërkimit individual me praninë e personelit mësimdhënës
- dalja jashtë nga mësimi

